



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SH.A. UJESJELLES  
ANSAMBLEJA E AKSIONEREVE  
PESHKOPI

Nr. 14 Prot

Peshkopi me 09/10/2013

Adresa : Rruga ish-Parkut, Lagjia V. Dibra; Nr. Tel/Fax: 0218 2761

V E N D I M

Nr. 2 date 09/10/2013

Per





**"MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TE STATUTIT TE SH.A. UJESJELLES  
PESHKOPI"**

Ansambleja e Aksionereve te Sh.A. Ujesjellesit Peshkopi ne zbatim te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregetare', Neni Nr.135, pika 2, germa b dhe Neni Nr.230 pika 2, si dhe Statutit te Sh.A. Ujesjellesi Peshkopi pasi u njoh me projekt-vendimin per miratim te ndryshimeve te Statutit te Sh.A. Ujesjellesit Peshkopi drejtuar nga Drejtori i Shoqerise:

**V E N D O S I:**


1. Te miratoje ndryshimin e Statutit te Sh.A. Ujesjellesit Peshkopi me dispozitat e Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare", sipas dokumentacionit bashkangjitur ketij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Shoqerise per kryerjen e procedurave te metejshme ,qe kane te bejne me depozitim e Statutit ne QKR, bashke me ndryshimet perkatese.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

1. Anetar Fadil Begu  
2. Anetar Fariz Karasani  
3. Anetar Hamit Pana  
4. Anetar Astrit Doçi  
5. Anetar Zeqir Çorja  
6. Anetar Kadri Visha

Firma   
Firma   
Firma   
Firma   
Firma   
Firma 

**KRYETARI I ANSAMBLESE SE AKSIONEREVE**

- Sabri LACI -




# STATUT

## I SHOQERISE ANONIME

### NENI 1 Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes shteterore  
"Ujesjellesi " Peshkopi .

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A "Ujesjellesi " Peshkopi .

Selia e shoqerise eshte ne adrese : Peshkopi .

### NENI 2 Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Prodhim furnizim shpermdarje uje te pishem te te gjithë konsumatorët familjare shteterore dhe private , mirembajtje dhe ruajtje objekti .

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.

### NENI 3 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 107.534.000 leke.Nga kjo vlera e truallit eshte 2.353.600. leke. Numri i aksioneve eshte107.534. Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.



## NENI 4

### Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

## NENI 5

### Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :


- 1) Keshilli mbikqyres
- 2) Drejtoria

## NENI 6

### Keshilli Mbikqyres

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.
- Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 (kater ) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithë te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

## NENI 7



## Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

### **NENI 8**

#### Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zevendes kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendes kryetari i keshillit mbikqyres.



## NENI 9

### Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershëm per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emerone drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshëm per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :
  - a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
  - b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
  - c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
  - d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshëm te shoqerise.
  - e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
  - f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjate.
  - g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjitheshme



## NENI 10

### Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

## NENI 11

### Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithë anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtores ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater ) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhjetë e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhjetë e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

## NENI 12

### Kompetencat e drejtorise

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.



- Ne marrëdhëniet me të tretet shoqëria merr përsipër detyrime që rrjedhin nga aktet e drejtorisë të nënshkruara nga anëtari me cilesinë e drejtorit edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretet e dinin që akti i drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretet nuk mund të injorin këto akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
- Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretave duhet të nënshkruhen nga anëtari me cilesinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm kur janë prezent jo më pak se gjysma e anëtarëve të sajë. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit të caktuar me cilesinë e drejtorit është përcaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlerë mbi 2 (dy) milion leke bëhet me autorizim të keshillit mbikqyres.
- Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton keshilli mbikqyres.

### NENI 13

#### Marreveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorisë ose të një anëtari të keshillit mbikqyres

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë ose një anëtari të keshillit mbikqyres, qoftë e drejtepërdrejtë ose jo e drejtepërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të keshillit mbikqyres.

Përcaktimi i mesipërme është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i keshillit mbikqyres është edhe anëtar i keshillit mbikqyres të një shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhen në kushte normale.

Anëtari i drejtorisë ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet të njoftojë keshillin mbikqyres për një marrëveshje për të cilën zbatohet kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjesë në votimin për dënimin e autorizimit.

*Real*

## **NENI 14**

### **Eksperti kontabel i autorizuar**

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1 ( \_nje\_ ) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajttesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

## **NENI 15**

### **Ushtrimi financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

## **NENI 16**

### **Inventari -llogarite vjetore**

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit te rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drjtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

## **NENI 17**

### **Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit**

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit. Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.



## **NENI 18**

### **Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres**

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen

- Xhavit DAJCI
- Xhelil PACI
- Alfred MERO

## **NENI 19**

### **Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar**

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n)

Z.Luan KAMBERI

## **NENI 20**

### **Asambleja e pergjithshme**

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

## **NENI 21**

### **Dispozita te fundit**

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar, drejtori i shoqerise do te jete drejtori i ish-ndermarrjes shteterore. Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit veç per shkaqe te perligjura.

## **NENI 22**

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.



# **STATUTI I SHOQERISE ANONIME “UJESJELLES – KANALIZIME” PESHKOPI**

## **Neni 1**

### **Emertimi**

Shoqeria emertohet Sh.A. “Ujesjelles Kanalizime” Peshkopi. Shkurtimi i emertimit te shoqerise eshte “UKD” sh.a. Emertimi i Shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

## **Neni 2**

### **Selia**

Selia e shoqerise eshte ne Peshkopi. Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte saj.

## **Neni 3**

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacioni ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj qendra dhe perfaqesi apo filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

## **Neni 4**

### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte pa afat te caktuar. Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here, me vendim te ansamblese se aksionereve.

## **Neni 5**

### **Objekti**

Objekti i shoqerise eshte :

1. Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij.
2. Mirembajtjen e sistemit(eve) te furnizimit me uje te pijshem.
3. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve.

4. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujerave të ndotura dhe shitja e tij.
5. Mirembajtja e sistemeve të ujerave të ndotura, si dhe impiante të pastrimit të tyre.  
Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.  
Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

## Neni 6

### Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 107.534.000 Lekë , i ndarë në 107.534 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000 (Njemije) leke secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar teresisht.

## Neni 7

### Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Pronesia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullareve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndermjetesve financiare.
3. Aksionet zotërohen në përqindje si më poshtë vijon:

3.1 Aksionari themelues: Bashkia Peshkopi ; lloji i kontributit: Në natyrë (Rrjet i brendshëm) numri i aksioneve: 39.572,51 cope; dhe vlera e aksioneve: 39.572.510 leke ; vlera e kontributit: 39.572.510 leke.

3.2 Aksionari themelues: Komuna Qender Tomin ; lloji i kontributit: Në natyrë (Rrjet kryesor) numri i aksioneve: 20.323,92 cope; dhe vlera e aksioneve: 20.323.920 leke ; vlera e kontributit: 20.323.920 leke.

3.3 Aksionari themelues: Komuna Sillove ; lloji i kontributit: Në natyrë (Rrjet kryesor) numri i aksioneve: 7.419,84 cope; dhe vlera e aksioneve: 7.419.840 leke ; vlera e kontributit: 7.419.840 leke.

3.4 Aksionari themelues: Komuna Fushe - Cidhen ; lloji i kontributit: Në natyrë (Rrjet kryesor) numri i aksioneve: 8.602,72 cope; dhe vlera e aksioneve: 8.602.720 leke ; vlera e kontributit: 8.602.720 leke.

3.5 Aksionari themelues: Komuna Luzni ; lloji i kontributit: Në natyrë (Veprë marrje, puse shuarje rrjet kryesor) numri i aksioneve: 7.957,51 cope; dhe vlera e aksioneve: 7.957.510 leke ; vlera e kontributit: 7.957.510 leke.

3.6 Aksionari themelues:Komuna Kala e Dodes ;lloji i kontributit: Ne natyre (Veper marrje,puse shuarje rrjet kryesor) numri i aksioneve: 7.204,77 cope; dhe vlera e aksioneve: 7.204.770 leke ; vlera e kontributit: 7.204.770 leke.

3.7 Aksionari themelues:Komuna Kastriot ;lloji i kontributit: Ne natyre (Rrjet kryesor) numri i aksioneve: 16.452,70 cope; dhe vlera e aksioneve: 16.452.700 leke ; vlera e kontributit: 16.452.700 leke.

## Neni 8

### Asambleja e aksionareve

Asambleja e aksionareve ,e zakonshme dhe e jashtezakonshme, mblidhet ne seline e shoqerise.Ajo thirret nga Keshilli Mbikeqyres apo Drejtori i Pergjithshem.Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu nga a)eksperti kontabel i autorizuar b)nga nje mandatmbajtes,i caktuar nga gjyqi,me kerkesen e cdo personi te autorizuar per nje rast urgjent ose c)nga likujduesi si dhe me kerkesen te aksionareve qe zoterojne te pakten 10 % te aksioneve te shoqerise.

## Neni 9

### Kompetencat e asamblese se zakonshme

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim,pervec atyre qe ne baze te ligjit apo ketij statuti duhen marre nga asambleja e jashtezakonshme.Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit,brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare,vetem ne qofte se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne sebashku te pakten 1/2 e aksioneve me te drejte vote.Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet , ne te dyten duhet te marrin pjese aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar , qe zoterojne sebashku te pakten 1/4 e aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e zakonshme merr vendimin me shumicen e votive qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar.

## Neni 10

### Kompetencat e asamblese se jashtezakonshme

Vetem asambleja e jashtezakonshme ka kompetenca te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij.Cdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhjen e pare zoterojne sebashku te pakten 2/3 e aksioneve.Ne mungese te ketij kuorumi mbledhja e dyte e asamblese thirret ne nje date te mevonshme,jo me larg se dy muaj nga data e thirrjes se

pare,dhe mund te marre vendime te vlefshme ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhjen e dyte zoterojne jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e jashtezakonshme merr vendimin me nje shumice votash prej 4/5 (80%) e votimeve qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar.

## Neni 11

### Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

1.Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKR.

2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

3.Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

## Neni 12

### Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901,ku duhen patjeter 3/4 e votave te aksionareve.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji,pra gjate marrjes duhet te jene te pranishem me shume se 1/2 e aksionareve qe zoterojne kapitalin dhe vendimin e posacem duhet ta miratojne 3/4 e aksionareve qe zoterojne aksione me perparesi.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

## KREU III

### Organet e Shoqerise

#### Neni 13

### Organet e Shoqerise

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli mbikëqyrës
3. Drejtor Ekzekutiv

#### Neni 14

### Ansambleja e Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 15

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Drejtori dhe nga anëtarët e Këshillit të Mbikqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit 9901, ku me se paku për të thirrur Ansamblene parashikohet që ky grup aksionarësh të kenë 5 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 i Ligjit, pra:

1. Nëse këto e parashikon Ligji i mesiperm Nr.9901, ose çdo ligj tjetër i Republikës së Shqipërisë si dhe dispozitat e këtij Statuti.
2. Kur sipas bilancit vjetor ose raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose parashikohet qarte se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 % të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kerkueshme brenda 3 muajve në vijim.
3. Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
4. Kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit propozon të blejë nga një aksionar pasuri që kanë vlerë me të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

## Neni 16

### Mbledhjet e Ansamblese së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto

aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

Administratori ose anëtari i Këshillit të Mbikqyrës pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

## **Neni 17**

### **Kuorumi**

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 18**

### **Marrja e Vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

## **Neni 19**

### **Keshilli Mbikqyrës**

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

Anëtarët e këshillit mbikqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit mbikqyrës mund të rizgjidhen.

Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga drejtori;
- b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga drejtori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- g) të emërojë dhe të shkarkojë drejtorin;
- h) të përcaktojë shpërblimin e drejtorit;

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë asamblesë të përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë së Këshillit Mbikëqyrës deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

1. Sabri Laci Adresa : Peshkopi
2. Isak Kaci Adresa : Peshkopi
3. Ciljeta Zuna Adresa : Peshkopi
4. Mensur Shehu Adresa : Vrenjt / Komuna Kastriot
5. Fatjon Kica Adresa : Ushtelenze / Komuna Tomin

3. Mandati i anetareve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 –vjeçar.

## Neni 20

### Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres

(1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e këtyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit, pra të jenë të pranishëm me shume se 1/2 e anetareve të Keshillit Mbikeqyres dhe me perjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statut. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë.

(3) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njëjloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

## Neni 21

### Procesverbalet e Keshillit Mbikeqyres

Këshillit Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

1. të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrin e Drejtorit të pranishëm në çdo mbledhje.

## Neni 22

### Largimi i anetareve të Keshillit Mbikeqyres

Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

1. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157, pra kur ai kryen funksione administrimi ne Shoqeri.
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

## Neni 23

### Drejtori

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron nje person fizikë si drejtor të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Drejtori i shoqërisë mund të rizgjidhet. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.
3. Drejtori ka keto të drejta dhe detyrime:
  - a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
  - d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - e) të raportojnë përpara këshillit mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
  - f) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - g) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

gj) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit mbikeqyres, nuk mund t'u delegohen drejtorit.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, drejtori duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit mbikeqyres.

6. Mandati i Drejtorit është 3 – vjeçar.

## Neni 24

### Shkarkimi i Drejtorit

Detyra e Drejtorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më drejtor në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

## KREU IV

### Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

## Neni 25

### Dividendet

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

## Neni 26

### Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Drejtori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

## KREU V

### Prishja dhe Njoftimet

## Neni 27

### Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

## Neni 28

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 29

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te linden ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linden midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Aksionarët Themelues të shoqërisë

\*SH.A. UJESJELLES – KANALIZIME PESHKOPI\*

Leqir Çorja

*[Signature]*

Kadri Vesho  
*[Signature]*

Lirz Scaroni

*[Signature]*

Hamit Zina  
*[Signature]*

Lolita Sae  
*[Signature]*

Arjtoni Erzakati  
— Sedri Kumbhari  
*[Signature]*

